



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2943/8 prot

Datë 20.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 1339/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.12.2023 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Kurbin me adresë: Lagjja Nr.3, Laç

- Ankimues:** “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, me NUIS K81314023A, me adresë: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuri e Llojit Njësi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë.
- “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, me NUIS M03116403L, me adresë: Rr. “BRIGADA XI SULMUESE”, L. APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Fier
- Subjekte të Interesuara:** “Eral Construction Company” SHPK, me NUIS K82230002K, me adresë: Rruga Tepelene, Progonat, Vendndodhja Skaranë, ngastra nr.80d, Kod kadastral Gj 3400080d rl,zk 1149
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.08.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

II.2. Në datën 06.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave, përkatësisht:

1. “Aida Constrktion” SHPK	6,445,815 lekë, skualifikuar
2. “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK	6,846,080 lekë, skualifikuar
3. “Colombo” SHPK	7,403,697 lekë, skualifikuar
4. “Eral Construction Company” SHPK	7,493,518 lekë, kualifikuar
5. “Klajger Konstruksion” SHPK,	7,617,628 lekë, kualifikuar

Shoqëria “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej saj, me argumentet si më poshtë vijon:

*Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ....., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:, “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, si më poshtë: • KVO konstatoi se operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara në*

*DST për mjetet (Automjet transporti 3-5 ton 2 copë & mjetet Kamionçina 2 copë). Së pari: Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Automjet transporti 3-5 ton, mjetet me targa AB483BD & AB926 JU). Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se për dy automjetet e transportit me targa AB483BD & AB926 JU, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST. Së dyti: Gjithashtu sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Kamionçinat me targa TR5568R, AA782CG, AA176YD, AB632JD). Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023 si dhe me Nr.5365 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se dy mjetet me targë AA782CG & AB632JD i plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, pasi për këto dy mjete ka paraqitur dokumentacion e plotë, ndërsa për Kamionçinat me targë TR5568R & AA176YD nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara nga AK në DST. Sqarojmë se për Kamionçinën me targë TR5568R, përveç kontratës së qirasë Nr.46 Prot, date 01.09.2023, nuk ka paraqitur fare dokumentacion tjetër, ndërsa për kamionçinën me targë AA176YD, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, Skualifikohet..”*

Shoqëria “AIDA CONSTRUCTION” SHPK është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej saj, me argumentet si më poshtë vijon:

*Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ....., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: I. OE nuk plotëson pikën 2.4.3 të DST, si më poshtë: 2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për te gjithë zerrat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. KVO konstatoi se: OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pasi nuk ka paraqitur analiza teknike të çmimeve për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës (sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015), si dhe ka mospërputhje, çmimi i përcaktuar në analizë me çmimin e vendosur në preventiv. Sqarojmë se, KVO pasi verifikoi Analizat Teknike që OE ka paraqitur në SPE si dhe Preventivin, konstatoi se ka mangësi për sa më poshtë vijon: I. OE nuk ka paraqitur fare analizë teknike çmimi për zerrat e preventivit si më poshtë: - Ndriçues tavanor fluoreshent 1x40ë*

(zë i cili është parashikuar në objektet, III, IX, XIII, XVI). 2. Për zërin: “F.V ËC alla frenga importi” ka çmim të ndryshëm preventivi me analizën teknike, ku sqarojmë se ky zë në preventiv ka çmimin 6,800 ndërsa në analizë 8600 (ky zë është në shtatë objekte, konkretisht tek II, VII, VIII, IX, X, XII, XV). 3. I njëjti zë në preventiv ka çmim ndryshe në objektin I & II, konkretisht Zëri: “Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar”, zë i cili në një objekt ka çmim 85, ndërsa tek objekti tjetër 100, ndërsa në analizë ka çmim 85.”

II.4. Në datën 20.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK rezulton i skualifikuar me argumentet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ...., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, si më poshtë:

- KVO konstatoi se operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara në DST për mjetet (Automjet transporti 3-5 ton 2 copë & mjetet Kamioçina 2 copë).

**Së pari:** Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Automjet transporti 3-5 ton, mjetet me targa AB483BD & AB926 JU).

Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se për dy automjetet e transportit me targa AB483BD & AB926JU, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST.

**Së dyti:** Gjithashtu sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Kamioçinat me targa TR5568R, AA782CG, AA176YD, AB632JD).

Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023 si dhe me Nr.5365 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se dy mjetet me targë AA782CG & AB632JD i plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, pasi për këto dy mjete ka paraqitur dokumentacion e plotë, ndërsa për

*Kamiocinat me targë TR5568R & AA176YD nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kritereve të përcaktuara nga AK në DST.*

*Sqarojmë se për Kamiocinën me targë TR5568R, përveç kontratës së qirasë Nr.46 Prot, date 01.09.2023, nuk ka paraqitur fare dokumentacion tjetër, ndërsa për kamiocinën me targë AA176YD, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST.*

***Si përfundim,** në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, **S’Kualifikohet.***

Operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentet e mëposhtme:

*Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ....., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: I. OE nuk plotëson pikën 2.4.3 të DST, si më poshtë: 2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për te gjithë zerrat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pasi nuk ka paraqitur analiza teknike të çmimeve për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës (sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015), si dhe ka mospërputhje, çmimi i përcaktuar në analizë me çmimin e vendosur në preventiv.*

*Sqarojmë se, KVO pasi verifikoi Analizat Teknike që OE ka paraqitur në SPE si dhe Preventivin, konstatoi se ka mangësi për sa më poshtë vijon:*

*1. OE nuk ka paraqitur fare analizë teknike çmimi për zërat e preventivit si më poshtë:*

*- Ndricules tavanor fluoreshent 1x40ë (zë i cili është parashikuar në objektet, III, IX, XIII, XVI).*

*2. Për zërin: “F.V ËC alla frenga importi” ka çmim të ndryshëm preventivi me analizën teknike, ku sqarojmë se ky zë në preventiv ka çmimin 6,800 ndërsa në analizë 8600 (ky zë është në shtatë objekte, konkretisht tek II, VII, VIII, IX, X, XII, XV).*

*3. I njëjti zë në preventiv ka çmim ndryshe në objektin I & II, konkretisht Zëri: “Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar”, zë i cili në një objekt ka çmim 85, ndërsa tek objekti tjetër 100, ndërsa në analizë ka çmim 85.*

II.5. Në datën 23.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2943/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3644 e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2943/2 prot, datë 24.11.2023.

II.5.2. Në datën 11.12.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2943/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.5516/5 prot., datë 07.12.2023, me objekt: *“Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK”*, bashkëngjitur vendimi Nr.1, datë 06.12.2023 i KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar kësaj shkrese, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka pranuar asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, duke e lënë atë të skualifikuar.

II.6. Në datën 23.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2951/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3646 e operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2951/2 date 30.11.2023, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK.

II.6.2. Në datën 11.12.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2951/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.5516/6 prot., datë 07.12.2023, me objekt: *“Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK”*, bashkëngjitur Vendimi Nr.2, datë 07.12.2023 i KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar kësaj shkrese, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka pranuar asnjë nga pretendimet e operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, duke e lënë atë të skualifikuar.

II.7. Njëpërmjet shkresës me nr. 2943/4 prot., datë 13.12.2023 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor dokumentacionin si vijon: “Në datën 23.11.2023, njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2943/2023 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3644 e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK. Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, por mungon dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të kualifikimit që lidhen me deklaratat e bëra nga ky i fundit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit përsa i përket makinerive. Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të paraqitur nga shoqëria “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me makineritë e deklaruara.”

II.8. Në datën 19.12.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2943/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 5516/8 prot., datë 15.12.2023 me objekt: “Dërgohet informacion për procedurën me nr.ref- 78188-08-23-2023, lidhur me ankesën e OE “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,



## Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.8. e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar, si më poshtë vijon:

**2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

- Automjet transporti (3-5 ton) 2 cope
- Kamionçina 4 cope
- Motobetoniere (250 L) 4 cope
- Pompe uji 4 cope
- Autobot Uji 1 cope
- Mjete e vegla pune suvatimi e bojatisje
- Skeleri + armatura derrase 1000 m<sup>2</sup>

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si: - **çertifikaten e pronësisë; -leja e qarkullimit; - çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracionin (i vlefshëm); Taksat Vjetore (e vlefshme).**

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbytur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

III.1.2. Në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “a” e dokumenteve të tenderit është parashikuar shprehimisht:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

III.1.3.Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, parashikohet si më poshtë vijon:

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p>	<p><u><i>Punonjës</i></u></p> <p><i>Po [ ] Jo [ ]</i></p> <p><i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i></p> <hr/> <p><i>Profili i punonjësve</i></p> <hr/> <p><u><i>Makineri e mjete</i></u></p> <p><i>Po [ ] Jo [ ]</i></p> <p><i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/>
<p><i>Emri, Mbiemri</i> _____</p> <p><i>Firma</i> _____</p> <p><i>Vula</i> _____</p> <p><i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____</p>	

*Ju lutemi sigurohuni që:*

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë*

*dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me originalin.*

*Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se shoqëria “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) ku në Deklaratën për disponimin e makinerive të nevojshme është plotësuar si vijon:

**C: DEKLARATË**

**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vij në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshte:*

Në pronësi					
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. qarkullimit	Lejes	Nr. Shasisë	Të tjera
1.Motobetoniere					Fature Tatimore nr.184 Dt 28.05.2021 Fature Tatimore Nr.154 Dt 12.04.2022 Fature Tatimore Nr.48 Dt 28.02.2008
2 Pompe Uji					Fature Tatimore Nr.40 Dt 28.01.2014
3. Mjete e vegla pune suvatimi e bojatisje					Fature Tatimore Nr.160 Dt 04.05.2022

MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE  
 NIPT : K81314023A  
 Kontakt : +355 68 20 77 724  
 E-mail :martinikonstruksion@gmail.com  
 Rruga e Durresit ,Hyrja Nr.3 ,Tirane ,Shqiperi



				Fature Tatimore Nr,1755 Dt 09.03.2022 Fature Tatimore 174 Dt 11.08.2022 Fature Tatimore Nr.21275 Dt 06.07.2019
4.Skeleri +Armature Derrase				Akte Zhdoganimi Fature Tatimore Nr.11 Dt 02.12.2021 Fature Tatimore Nr.174 Dt 31.07.2020 Fature Tatimore Nr.9 Dt 30.11.2021 Fature Tatimore Nr.10 Dt 30.11.2021

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1. Automjet transporti 3-5 ton	AI D	TRF 523	WD 38	Nr. Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
	AI	TRL 523	WI	Nr. Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese



					shoqeria shpallet fituese
2 Kamioncina	TR 568R	TR 568R	ZC	Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
	AA 782CG	TR 568R	WE	Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
	AA 176YD	TR 568R	WE N40	Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
	AB 483BD	TR 568R	WVIZZ2FZ	Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
3. Autobot Uji	AA 782CG	TR 568R	KM 1C	Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese
4. Motobetonie re				Nr. 46 Prot	Dt.01.09.2023- Perfundim te plote te punimeve ne objekt ,nese shoqeria shpallet fituese

III.1.6. Në ankesën e paraqitur nga shoqëria “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, pretendohet si vijon:

“[...] Shoqeria ne permbushje te kriterit te mesiperm ka deklaruar ne formularin permbledhes mjetet me targa AA782CG, TR568R, AA176YD dhe mjetet me targa AB483BD dhe AB926JU, si edhe ne fazen e dorezimit te dokumentacionit provues shoqeria ka dorezuar kontrate qiraje Nr.46 Prot Date 01.09.2023 lidhur mes shoqerise Skela Martini ne cilesine e qiradhenesit dhe shoqerise “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” shpk ne cilesine e qiramarresit. Ne kontraten e qirase se paraqitur me numer 46 prot date 01.09.2023 pervec kontrates bashkelidhur eshte edhe i gjithe dokumentacioni i mjeteve. Lidhur me pretendimin e autoriteti

kontraktor qe per mjetin me targe TR5568R nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion, informojme se ne kontraten e qirase se paraqitur nga ana jone i gjithë dokumentacioni per kete mjetin ka qene i bashkelidhur. Bashkelidhur me kete ankese po ju dorezojme kontraten origjinale mes paleve. Autoriteti Kontraktor nuk mund kurrsesi te pretendoje qe dokumentacioni per kete mjet nuk eshte paraqitur pasi ai ka qene pjese integrale e kontrates qe ne kemi depozituar se bashku me dokumentacionin provues. Nese autoriteti kontraktor eshte treguar i pakujdesshem apo neglizhent me apo pa dashje, ne vleresim apo mbajtjen fizike te dokumentacionit te depozituar nga ana jone, kjo nuk eshte pergjegjesi e operatorit ekonomik. Shihet fare qarte qe dokumentacioni per kete mjete ka qene pjese integrale e kontrates, si edhe i permendur ne shkresen percjellese te dorezimit te dokumentacionin ne protokollin e AK. Nje kopje te shkreses mbi dorezimin e dokumentacionit provues e gjeni bashkelidhur kesaj ankese. Sikunder referohet ne vendime te meparshme te KPP-se per analogji, kriteret per kualifikim i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe ne si shoqeri zoterojme te gjithë kapacitet profesionale, teknike ekonomike e financiare per te permbushur me sukses kete kontrate. Lidhur me mungesen e taksave vjetore per mjetet me targe AB483BD dhe AB926JU, autoriteti ka te gjitha mjetet e nevojshme per te verifikuar nese per keto mjete jane paguar taksat apo jo. Bashkelidhur print screen nga e-albania e shoqerise pronare te mjeteve ku lehtesisht verifikohet fakti qe taksat per keto mjete jane paguar, pavaresisht se nuk disponohet dokumenti fizik. Referuar nenin 92 te LPP AK ka patur detyrimin procedural qe per kete aspekt, te kerkonte dokumentacion shtese apo sqarime nese ai ka patur dyshime mbi disponim e ketyre makinerive nga ana jone, gje te cilin AK jo vetem qe nuk e ka bere, por as e ka marre mundimin qe te kryej verifikimet perkatese prane institucioneve, duke e marre te mireqene qe shoqeria, nuk ploteson kapacitetin ne lidhje me disponimin e mjeteve.

Lidhur me mungesen e taksave dhe tarifave vendore per mjetin me targe AA176YD, vertet ne si shoqeri nuk kemi paraqitur pagesen e taksave dhe tarifave vendore, por serisht jemi para faktit qe AK duhet te n'a kishte kerkuar sqarime lidhur me kete pike. Deshirojme te sqarojme qe per kete mjet nga departamenti mekanik perkates i shoqerise nen zoterim te se ciles jane mjetet, ka ndodhur nje gabim njerezor e ngaterrese lidhur me pagesen taksave te ketij mjeti. Per kete fakt bashkelidhur ju paraqesin pagesen e taksave per kete mjet .

Ne konkluzion, jemi para faktit qe shoqeria jone disponon te gjithë kapacitet ekonomike financiare, profesionale perfshire mjetet dhe pajisjet per realizimin me sukses te kesaj kontrate. Fakti qe nuk jane paraqitur pagesa e taksave te mjeteve, ne kendveshtirimin tone perben nje devijim te vogel, i cili per efekt te nenshkrimin te kontrates nuk ka asnje ndikim, sikunder percaktohet edhe ne LPP. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj, si edhe ato te lidhura me informacionet qe merren lehtesisht nga dokumente faktike, qe tregojne gjendjen e operatorit ekonomik ne kohen e ofertimit.

*Pra jemi para faktit qe shoqeria ka vertetuar se disponon dhe do te kete ne dispzocion mjetet dhe pajisjet e duhura per realizimin e kesaj kontrate, dhe nuk egziston asnje pengese qe shoqeria te mos permbush me sukses kete kontrate. Per me teper, sikunder shprehet KPP ne vendime te tjera per analogji, vete Autoritetit Kontraktor eshte ai i cili ka interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates si edhe mireperdorimin e fondeve publike. Ne kendveshtrimin tone nuk eshte e arsyeshme dhe logjikshme qe per shkak te mosperparaqitjes se taksave te mjeteve, oferta e shoqerise tone te skualifikohet dhe per me teper nga ana e AK te shpallet fitues nje operator tjetër, i cili ne raport me oferten tone ka goxha diference monetare rreth 10 % ka ofertuar me teper, gjithmone ne kuader te procedures objekt prokurimi. Kjo lloj zgjidhje perpos qe demton buxhetin e shtetit financiarisht, ul edhe kredibilitetin e AK ne shoqeri lidhur me mireperdorimin e fondeve publike.”*

III.1.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.8. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë

dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

**2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.1.10. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;



ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

**i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.**

III.1.12. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.14. Lidhur me argumentin e AK-së se: “[...] për Kamiocinën me targë TR5568R, përveç kontratës së qirasë Nr.46 Prot, date 01.09.2023, nuk ka paraqitur fare dokumentacion tjetër [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga ana e ankimuesit është deklaruar se disponohet me qira Kamiocina me targë TR5568R. Sipas ankimuesit, në dokumentacionin e dorëzuar në autoritetin kontraktor, në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, është paraqitur kontrata dhe i gjithë dokumentacioni për mjetin ka qenë i bashkëlidhur. Gjithashtu, rezultoi, se në ankesën e paraqitur në sistemin e ankesave elektronike, ankimuesi ka ngarkuar edhe dokumentacionin e mjetit me targë TR5568R dhe konkretisht është dorëzuar:

1. Kontrata e qirasë datë 01.09.2023, e lidhur me shoqërinë “Skela Martini” për dhënien me qira të mjetit [...] kamioncinë me targë TR5568R, (si dhe të mjeteve të tjera).
2. Certifikata e pronësisë së mjetit në emër të “Skela Martini” SHPK
3. Leja e qarkullimit
4. Siguracioni i mjetit me datë 02.12.2022 deri 02.12.2023.
5. Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore e vlefshme deri më datë 07.12.2023
6. Taksa vjetore e mjetit e vlefshme deri më datë 07.12.2023
7. Fotografi e mjetit me targë TR5568R

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponon mjetin me targë TR5568R dhe ka dorëzuar të gjithë dokumentacion e kërkuar nga AK në dokumentet e tenderit, sipas përcaktimeve të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit si më sipër cituar.

Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Por konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastin konkret, për sa i përket mjetit me targë TR5568R rezulton, se ankimuesi ka paraqitur Kontratën e qirasë datë 01.09.2023, e lidhur me shoqërinë “Skela Martini” për dhënien me qira të mjetit [...] kamioncinë me targë TR5568R, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objekt ankimi; Certifikatën e pronësisë së mjetit në emër të “Skela Martini” SHPK; Lejen e qarkullimit; Siguracionin e mjetit me datë 02.12.2022 deri 02.12.2023; Certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore e vlefshme deri më datë 07.12.2023; Taksën vjetore të mjetit, e vlefshme deri më datë 07.12.2023 si dhe Fotografinë e mjetit me targë TR5568R, pra ka paraqitur dokumentacionin e plotë që provon plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit ku është parashikuar se për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si: - **certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik** (e vlefshme); **siguracionin** (i vlefshëm); **Taksat Vjetore** (e vlefshme). Ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK qëndrojnë.

III.1.15. Lidhur me mangësitë e konstatuara nga AK për mjetin me targë AA176YD, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit për pagesën e taksës vjetore të mjetit me targë AA176YD, shoqëria ankimuese ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit se nga ana e këtij të fundit disponohet me qira ky mjet, sipas kontratës me nr. 46 prot., me afat të kontratës së qirasë, duke filluar nga data 01.09.2023, deri në përfundim të plotë të punimeve në objekt, nëse shoqëria shpallet fituese.

Rezulton, se Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.** Pra në rastin konkret autoriteti kontraktor i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimues e plotëson këtë kriter. Nga ana e ankimuesit, për mjetin në fjalë është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor, nga shqyrtimi i të cilit KVO ka gjykuar, se nuk përmbushen kërkesat e autoritetit kontraktor për mjetin me targë AA176YD, siç është bërë me dije edhe në njoftimin e skualifikimit, si më sipër cituar.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se ankimuesi në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës dhe konkretisht ka deklaruar mjetet në shtojcën përkatëse. Lidhur me mungesën e taksave vjetore për mjetin me targë AA176YD, shoqëria ankimuese pohon faktin se nga ana e tij nuk është paraqitur kjo taksë, por sqaron se *nga departamenti mekanik perkates i shoqerise nen zoterim te se ciles jane mjetet, ka ndodhur nje gabim njerezor e ngaterrese lidhur me pagesen taksave te ketij mjete. Per kete fakt bashkelidhur ju paraqesin pagesen e taksave per kete mjet.* Nga shqyrtimi i dokumentit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të paraqitur nga shoqëria ankimuese, në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, rezulton se taksat vjetore për mjetin me targë AA176YD, kanë datën 21.11.2023, pas datës së zhvillimit së procedurës së prokurimit (datë 04.09.2023).

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nuk ka paraqitur taksat vjetore për mjetin me targë AA176YD. Operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve *para hapjes së ofertave*. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Fakti i

mosdorëzimit të taksës vjetore për mjetin me targë AA176YD, sipas kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pranohet edhe nga vetë ankimesi, në ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor dhe KPP, kur shprehet se është bërë *nje gabim njezror e ngaterrese lidhur me pagesen taksave te ketij mjete*. Operatori ekonomik ankimes duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit ofertës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP-ja nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili sigurohet pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Në këtë rast dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimesit në tender paraqet mangësi në përmbajtje dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

III.1.16. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi ankimesi nuk përmbush kriterin e kualifikimit për sa i përket mjetit me targë AA176YD dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “AIDA CONSTRUCTION” SHPK me argumentat e mëposhtme: *“Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ...., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për*

kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: I. OE nuk plotëson pikën 2.4.3 të DST, si më poshtë: 2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pasi nuk ka paraqitur analiza teknike të çmimeve për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës (sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015), si dhe ka mospërputhje, çmimi i përcaktuar në analizë me çmimin e vendosur në preventiv. Sqarojmë se, KVO pasi verifikoi Analizat Teknike që OE ka paraqitur në SPE si dhe Preventivin, konstatoi se ka mangësi për sa më poshtë vijon: OE nuk ka paraqitur fare analizë teknike çmimi për zerrat e preventivit si më poshtë:  
-Ndricues tavanor fluoreshent 1x40ë (zë i cili është parashikuar në objektet, III, IX, XIII, XVI. Për zërin: “F.V ËC alla frenga importi” ka çmim të ndryshëm preventivi me analizën teknike, ku sqarojmë se ky zë në preventiv ka çmimin 6,800 ndërsa në analizë 8600 (ky zë është në shtatë objekte, konkretisht tek II, VII, VIII, IX, X, XII, XV) .I njëjti zë në preventiv ka çmim ndryshe në objektin I & II, konkretisht Zëri: “Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar”, zë i cili në një objekt ka çmim 85, ndërsa tek objekti tjetër 100, ndërsa në analizë ka çmim 85”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr. 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 2.4.3 “Kapaciteti Teknik” në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

**2.4.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga subjekti “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

1. Listën e çmimeve sipas zërave të preventivit
2. File: Analiza e çmimeve Bashkia Kurbin;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe

*judiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Neni 93 Oferta anomalisht e ulët të LPP-së përcakton se:

*1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:*

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

*d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

Në pikën 4, të “Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4.as korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

*Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*

*Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

**III.2.4. VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) 1. Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi. 4. Çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualet teknike, janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor.**

**VENDIM Nr.514, datë 15.8.2007 PËR INFORMATIZIMIN E LLOGARITJES SË KOSTOS DHE HARTIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT**

**1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.**

**2. Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në përputhje me këtë vendim.**

**4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e përdorura në këtë vendim kanë kuptimin, si më poshtë vijon: dh) manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi; e) buletini i**



çmimeve të materialeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe i produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit;

9. Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tendera publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

III.2.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar frymës së legjislationit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat

e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Duke iu referuar hartimit të kriterit në dokumentet standarde të tenderit, në pikën 2.4.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, në kundërshtim me nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilave, në rastet kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune, shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë si dhe ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

Në këtë kontekst kriteri është në kundërshtim me nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Mënyra e plotësimit të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e analizave teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit, kërkohet në rastet kur autoriteti kontraktor evidenton një oferte anomalisht të ulët, pra ky është edhe momenti procedural, kur autoritetet kontraktore kërkojnë të analizojnë hollësisht ofertën ekonomike të paraqitur nga subjekti, oferta e të cilit ka rezultuar anomalisht e ulët. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e

natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.2.7. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret e kualifikimit në lidhje me kërkesën për paraqitjen e analizës teknike *analizë teknike të çmimeve për te gjithë zerat e preventivit të ofertës*, në kundërshtim me nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të LPP-së dhe pikës 4, të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’”, i ndryshuar, përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe

*Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “*Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin*” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**